


**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"EURO ADITIV" SH.P.K.**



Sot, më datë 13 Qershor 2006 ne te nenshkruarit :

- 1 Z. DRITAN BUJAMIN SHEHU, shtetas shqiptar, lindur më 01/05/1967, në Tirane, Shqiperi, banues në adresën : Rr. Durrësit, Pll. 240, Shk. 4, Ap 33, mbajtës i pasaportes me nr. Z1380001, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar;
2. Z. ARTAN NIKOLLA DULAKU, lindur me 30.05.1965 dhe banues ne Tirane,Rruga "Gjin Bue Shpata", madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes Nr. Z 0031648;
- 3 Z. AQIF MALIQ SINA, shtetas shqiptar, lindur më 01.07.1963, ne Tirane, banues në Tirane -Shqiperi, mbajtës i pasaportes me nr. 1009997, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar;
- 4 Z. BUJAR KOVAÇ HASAJ, shtetas shqiptar, lindur më 15, Shkurt 1961, ne Fier, Shqiperi, banues në adresën: rruga "Ismail Qemali" Pall. 34/1, Ap.10/1, Tirane, Shqiperi, mbajtës i pasaportes me nr. 0013321, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar;
- 5 Z.GUXIM BYBERI, lindur më 10.06.1965 banues e ne Tirane, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i pasaportes NR.Z0520502;
- 6 EDLIRA XHEMAL ZENELAJ, shtetas shqiptar, lindur më 13.03.1964, ne Tiranë, Shqiperi, banues e ne Tirane, Shqiperi, mbajtës i pasaportes me nr. Z.1841383, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar;
- 7 Z. ADRIAN MIHAL MUKA, shtetas shqiptar, lindur më 05.08.1967 dhe banues ne Durres,Lagje Nr.6,Rruga "Bashkimi" Nr.65i, mbajtës i pasaportes me nr. Z0003418, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar;

në përputhje me Ligjin Nr. 7638, datë 19.11.1992, "Për Shoqëritë Tregtare" kemi vendosur të themelojme një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar "EURO ADITIV" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria"), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi.

Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është perpiluar dhe miratuar nga ortaket Themelues te shoqerise "EURO ADITIV" Sh.p.k.

**Neni 1**  
Emri i Shoqërisë është " EURO ADITIV" **Sh.p.k.**

## Neni 2

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Jorgan Misja" ish Uzina Mekanike Bujqesore.

Shoqëria ka të drejtë të hapë dege apo filiale në të gjithë vendin.

## Neni 3

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë e pakufizuar mbi 10 vjet, duke filluar që prej datës së regjistrimit të saj në Rregjistrin e Shoqërive Tregtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## Neni 4

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është si më poshtë:

- Prodhimi, shitja, blerja, tregtimi me shumicë dhe pakicë i produkteve me origjinë kimike për materialet e ndërtimit, importi dhe eksporti i tyre brenda dhe jashtë vendit për llogari të vetë shoqërisë si dhe të tretëve, ku përfshihen aditive për beton, aditive për cemento, disarmante, fibra sintetike dhe celiku, llac i gatshëm, bojra, kollë, polisterol izolues, llaqe, sisteme për fiksion dhe ngritje të paneleve parafabrikat dhe të elementeve të ndryshëm prej betoni, cemento, rërë, shitja e aparateve dhe makinarive që përdoren për aplikimin e këtyre materialeve si dhe çdo material tjetër për ndërtim.

Kjo shoqëri mund të ndërmarrë si në Shqipëri dhe jashtë saj aktivitete industriale dhe tregtare që kanë lidhje me objektin e me sipërm.

Shoqëria zhvillon gjithashtu veprimtari ndihmese mobiliare, imobiliare, tregtare, industriale që kanë lidhje me objektin e saj e që mundet të lehtësojnë veprimtari në saj. Gjithashtu ajo mund të bashkëpunojë dhe të marrë pjesë direkt ose indirekt në shoqëri të tjera që kanë objekt veprimtari të ngjajshëm me të saj.


- Shoqëria ndërmjetëson për nxjerrjen dhe perpunimin e lendeve të para të të gjitha llojeve, për veprimtari shërbime, etj.

- Shoqëria kontraktin me persona fizikë dhe juridikë vendas ose të huaj për gjetjen e tregjeve të shitjes dhe të blerjes për prodhimet e shoqërisë.

## Neni 5

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 leke dhe është i ndarë në 100 pjesë kapitali me të njëjten madhësi, vlera nominale e të cilave është 1000 leke. Kontributi i çdo ortaku në kapitalin themeltar të shoqërisë është si më poshtë:

1. Z. DRITAN SHEHU, zoteron 40% të kapitalit ose 40 pjesë kapitali me vlerë prej 40.000 Leke.
2. Z. ARTAN DULAKU zoteron 10% të kapitalit ose 10 pjesë kapitali me vlerë prej 10.000 Leke.
3. Z. AQIF SINA, zoteron 10% të kapitalit ose 10 pjesë kapitali me vlerë prej 10.000 Leke.
4. Z. BUJAR HASAJ, zoteron 10% të kapitalit ose 10 pjesë kapitali me vlerë prej 10.000 Leke.

- 
5. Z. Guxim BYBERI, zoteron 10% të kapitalit ose 10 pjese kapitali me vlere prej 10.000 (dhjete mije) Leke.
  6. Z. EDLIRA ZENELAJ, zoteron 10% të kapitalit ose 10 pjese kapitali me vlere prej 10.000 (dhjete mije) Leke.
  7. Z. ADRIAN MUKA, zoteron 10% të kapitalit ose 10 pjese kapitali me vlere prej 10.000 (dhjete mije) Leke.

Ortakët kanë krijuar kapital themelor, shumën prej 100.000 leke, dhe e kanë depozituar atë pranë Zyres Noteriale për të mundësuar krijimin e shoqërisë

Ortakët mund të vendosin për rritjen e kapitalit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.  
Detyrimet e çdo ortaku kundrejt shoqërisë përballohen vetëm për pjesën e kapitalit të dërdhur nga ai. Për detyrimet e tjera të shoqërisë ortaku nuk mban përgjegjësi.

#### **Neni 6**

Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga vetë ortakët e shoqërisë. Organet drejtuese të shoqërisë "EURO ADITIV" Sh.p.k. janë:

1. Asambleja e Ortakëve
2. Administratori

Administratori i shoqërisë është :

- Z. Dritan Shehu

Menyra dhe Administrimi i shoqërisë është i përcaktuar në Statutin e shoqërisë.

#### **Neni 7**

Ortakët e shoqërisë janë të detyruar që të ruajnë sekretin e dokumentacionit dhe të informacionit si dhe eksperiencën e realizuar brenda kontekstit të shoqërisë dhe të evitojnë përhapjen e tyre qoftë dhe pjesërisht.

### Neni 8

Ne se shoqëria do te likuidohet atehere do te caktohet nje komision likuidimi qe do te parashtroje nje bilanc likuidimi per miratim.

### Neni 9

Çdo mosmarrëveshje që lind ndërmjet ortakëve në lidhje me këtë marrëveshje apo Shoqërinë (përveç atyre personale apo që nuk kanë të bëjnë me Shoqërinë), do të zgjidhet me mirëkuptim dhe do të diskutohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje me mirëkuptim të mosmarrëveshjes, çështja do t'i kalojë për gjykim Gjykatës së Rrethit Tiranë.

### Neni 10

Akti i Themelimit eshte hartuar ne 4 kopje origjinale ne gjuhen shqipe.

### ORTAKET

- z. Ajip Sina
- z. JRITAN SHERU
- z. Artan Dulafu
- z. Artan Dulafu
- z. Edlira Zenelaj
- z. Genar Bytyci
- z. Beyan Hasaj
- z. \_\_\_\_\_

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
SHKOMBIA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 6609 rep.  
Nr. 1088 Kol.

V E R T E T I M

Vertetohet se sot ne daten 20 Qershor 2006 (dymije e gjashte), u paraqiten personalisht, para meje, notere Ruko SAKO, me adrese ne Bulevardin " Zog I", ne katin e dyte te pallatit 12 katesh,

Z. DRITAN BUJAMIN SHEHU, shtetas shqiptar, lindur më 01/05/1967, në Tirane, Shqiperi, banues në adresën : Rr. Durrësit, Pll. 240, Shk. 4, Ap 33, mbajtës i pasaportes me nr. Z1380001, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

Z. ARTAN NIKOLLA DULAKU, lindur me 30.05.1965 dhe banues ne Tirane, Rruga "Gjin Bue Shpata", madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes Nr. Z 0031648.

Z. AQIF MALIQ SINA, shtetas shqiptar, lindur më 01.07.1963, ne Tirane, banues në Tirane- Shqiperi, mbajtës i pasaportes me nr.1009997, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

Z. BUJAR KOVAÇ HASAJ, shtetas shqiptar, lindur më 15, Shkurt 1961, ne Fier, Shqiperi, banues në adresën: rruga "Ismail Qemali" Pall. 34/1, Ap.10/1, Tirane, Shqiperi, mbajtës i pasaportes me nr. 0013321, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

Z. GUXIM BYBERI, LINDUR ME 10.06.1965 DHE BANUES NE TIRANE, MADHOR, ME ZOTESI TE PLOTE JURIDIKE PER TE VEPRUAR, MBAJTES I PASAPORTES NR. Z0520502.

Z. EDLIRA XHEMAL ZENELAJ, shtetas shqiptar, lindur më 13.03.1964, ne Tiranë, Shqiperi, banues e ne Tirane, Shqiperi, mbajtës i pasaportes me nr. Z.1841383, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

Z. ADRIAN MIHAL MUKA, shtetas shqiptar, lindur më 05.08.1967 dhe banues ne Durrës, Lagje Nr.6, Rruga "Bashkimi" Nr.65i, mbajtës i pasaportes me nr. Z0003418, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

Te cilet nenshkruan rregullisht aktin e mesiperm dhe une noterja vertetoj sipas ligjit, nenshkrimet e tyre.

N O T E R E  
RUKO SAKO





## **STATUTI I SHOQËRISË**

### **"EURO ADITIV" SHPK**

Në bazë të ligjit 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", dhe ligjit 7667 datë 28.1.1993 "Për Regjistrin Tregtar", ne të nënshkruarit shpallim si më poshtë vijon:

### **FORMIMI I SHOQËRISË**

#### **Neni 1**

Formohet shoqëria e quajtur "EURO ADITIV" SHPK me ortakë :

1. Z. DRITAN BUJAMIN SHEHU, shtetas shqiptar, lindur më 01/05/1967, në Tirane, Shqiperi, banues në adresën : Rr. Durrësit, Pll. 240, Shk. 4, Ap 33, mbajtës i pasaportes me nr. Z1380001, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.
2. Z. ARTAN NIKOLLA DULAKU, lindur me 30.05.1965 dhe banues ne Tirane,Rruga "Gjin Bue Shpata", madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes Nr. Z 0031648.
3. Z. AQIF MALIQ SINA, shtetas shqiptar, lindur më 01.07.1963, ne Tirane, banues në Tirane -Shqiperi, mbajtës i pasaportes me nr. 1009997, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.
4. Z. BUJAR KOVAÇ HASAJ, shtetas shqiptar, lindur më 15, Shkurt 1961, ne Fier, Shqiperi, banues në adresën: rruga "Ismail Qemali" Pall. 34/1, Ap.10/1, Tirane, Shqiperi, mbajtës i pasaportes me nr. 0013321, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.
5. Z.GUXIM BYBERI, lindur më 10.06.1965 banues e ne Tirane, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i pasaportes NR.Z0520502.
6. EDLIRA XHEMAL ZENELAJ, shtetas shqiptar, lindur më 13.03.1964, ne Tiranë, Shqiperi, banues e ne Tirane, Shqiperi, mbajtës i pasaportes me nr. Z.1841383, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.
7. Z. ADRIAN MIHAL MUKA, shtetas shqiptar, lindur më 05.08.1967 dhe banues ne Durrës,Lagje Nr.6,Rruga "Bashkimi" Nr.65i, mbajtës i pasaportes me nr. Z0003418, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

#### **NENI 2**

### **QENDRA E SHOQËRISË**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën Rruga "Jordan Misja", ish Uzina Mekanike Bujqesore Tirane. Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithë vendin.

#### **Neni 3**

### **KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË EKONOMIKE**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e pakufizuar mbi 10 vjet dhe fillon që prej datës së regjistrimit të saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë

## **OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

### **Neni 4**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është si më poshtë:

- Prodhim, shitja, blerja, tregtimi me shumicë dhe pakicë i produkteve me origjinë kimike për materialet e ndërtimit, importi dhe eksporti i tyre brenda dhe jashtë vendit për llogari të vetë shoqërisë si dhe të tretëve, ku përfshihen aditive për beton, aditive për cemento, disarmante, fibra sintetike dhe celiku, llac i gatshëm, bojra, kollë, polisterol izolues, llaqe, sisteme për fiksion dhe ngritje të paneleve parafabrikat dhe të elementeve të ndryshëm prej betoni, cemento, rërë, shitja e aparateve dhe makinave që përdoren për aplikimin e këtyre materialeve si dhe çdo material tjetër për ndërtim.

Kjo shoqëri mund të ndërmarrë si në Shqipëri dhe jashtë saj aktivitete industriale dhe tregtare që kanë lidhje me objektin e më sipër.

Shoqëria zhvillon gjithashtu veprimtari ndihmese mobiliare, imobiliare, tregtare, industriale që kanë lidhje me objektin e saj e që mundet të lehtësojë veprimtarinë e saj. Gjithashtu ajo mund të bashkëpunojë dhe të marrë pjesë direkt ose indirekt në shoqëri të tjera që kanë objekt veprimtarie të ngjajshëm me të sajën.

- Shoqëria ndërmjetëson për nxjerrjen dhe perpunimin e lendeve të para të të gjitha llojeve, për veprimtari shtesë, etj.

- Shoqëria kontraktin me persona fizikë dhe juridikë vendas ose të huaj për gjetjen e tregjeve të shitjes dhe të blerjes për prodhimet e shoqërisë.

### **Neni 5**

Kjo shoqëri mund të ndryshojë emërtimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, të risë kapitalin sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve.


## **KAPITALI I SHOQËRISË**

### **Neni 6**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë dhe është i ndarë në 100 pjesë të kapitalit të të njëjtes madhësi me vlerë nominale 1.000 lekë çdo pjesë kapitali. Çdo ortak ka të drejtën e votës në përputhje me numrin e pjesëve të kapitalit që ai zoteron në këtë shoqëri.

Kontributi i ortakëve në kapitalin themeltar është si më poshtë:

- 1 Z. DRITAN SHEHU, zoteron 40% të kapitalit ose 40 pjesë kapitali me vlerë prej 40.000 Leke.
- 2 Z. ARTAN DULAKU zoteron 10% të kapitalit ose 10 pjesë kapitali me vlerë prej 10.000 Leke.
- 3 Z. AQIF SINA, zoteron 10% të kapitalit ose 10 pjesë kapitali me vlerë prej 10.000 Leke.
- 4 Z. BUJAR HASAJ, zoteron 10% të kapitalit ose 10 pjesë kapitali me vlerë prej 10.000 Leke.
- 5 Z. Guxim BYBERI zoteron 10% të kapitalit ose 10 pjesë kapitali me vlerë prej 10.000 Leke.

- 
- 6 Z. EDLIRA ZENELAJ, zoteron 10% të kapitalit ose 10 pjesë kapitali me vlerë prej 10.000(dhjetë mijë) Leke.
  - 7 Z. ADRIAN MUKA, zoteron 10% të kapitalit ose 10 pjesë kapitali me vlerë prej 10.000(dhjetë mijë) Leke.

#### **Neni 7**

Ky kapital mund të shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit të të gjithë ortakëve.

### **DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI**

#### **Neni 8**

Shoqëria tregtare deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që përmban ky Statut si dhe të legjislacionit shoqiptar në fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar në datën e regjistrimit në Regjistrin Tregtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqsor Tiranë dhe pasi të marrë licensën përkatëse nga organi përkatës tatimor.

#### **Neni 9**

Ortakët e shoqërisë me krijimin e kësaj shoqërie pjesën e kapitalit të derdhur prej tyre nuk mund ta tërheqin. Kjo mund të bëhet vetëm pasi të nxirret bilanci i shoqërisë për fitimin e realizuar.

#### **Neni 10**

Pjesët e kapitalit të cdo ortaku përputhen me pjesën e tyre në kapitalin themelor të shoqërisë. Nëqoftese ortaku siguron pjesë të tjera kapitali atëherë pjesa e tij në kapitalin e shoqërisë rritet në përputhje me të. Pjesët e tij ortaku i shoqërisë mund t'ua ofrojë të tretëve. Ortaket e shoqërisë kanë përparësi për blerjen e pjesës së kapitalit përpara personave të tretë jashtë shoqërisë. Ortaku që dëshiron të transferojë ose të shesë kuotat e tij i drejton një kërkesë me shkrim Organit Administrativ duke saktësuar cmimin e shitjes, i cili duhet të jetë i arsyeshëm dhe të jetë i njëjtë me atë që do t'i ofrohet dhe një personi të tretë jashtë shoqërisë si dhe të dhënat e blerësit. Organi administrativ jep përgjigje brenda 30 ditëve nga data e njoftimit dhe duhet t'ua transmetojë ortakëve të tjerë këtë kërkesë. E drejta e përparësisë është në proporcion me kuotat e secilit prej ortakëve.

Organi Administrativ pasi ka kaluar afati prej 3 muajsh, i komunikon ortakut që shet kuotat e tij vendimin e ortakëve të tjerë për të blerë të gjithë ose pjesërisht kuotat e tij. Në rast se kuotat nuk shiten brenda shoqërisë, atëherë keto kuota brenda 90 ditëve i ofrohen personave të tretë jashtë shoqërisë. Transferimi dhe shitja e kuotave duhet të bëhen me akte noteriale dhe një kopje e këtij akti duhet të depozitohet në librin e Ortakëve.

Po kështu transferimi i kuotave në rrugë trashëgimie bëhet sipas neneve 46, 47, 49 të ligjit 7638 dt 19.11.1992. Të gjitha transferimet kanë efekt mbi shoqërinë që nga momenti i regjistrimit në librin e Ortakëve. Kuotat prej 1.000 lekë janë të pandashme. Në rastet e bashkëpronësisë veprohet sipas ligjeve.



### **Neni 11**

Emërtimi i shoqërisë tregtare, kapitali themeltar, emrat e administratorëve, si dhe emrat e Ortakëve duhet të jenë të përmendura në të gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqëri dhe që ju drejtohen të tretëve. Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme dhe me përmbajtjen përreth saj.

### **Neni 12**

Shoqëria vepron nën regjimin e pronës private dhe merr përsipër vetë të drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtëkontraktore. Ortakët e shoqërisë drejtojnë procesin për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë si dhe për detyrimet që ka shoqëria ndaj të tretëve pa asnjë kufizim.

Organet e shoqërisë janë:

- 1- Asambleja e Ortakëve
- 2- Administratori

## **A S A M B L E J A E O R T A K E V E**

### **Neni 13**

Organi më i lartë i shoqërisë është Asambleja e cila mbledhet me kërkesen të çdo anëtar të shoqërisë që përfaqëson të paktën 10% të kapitalit të shoqërisë ose me kërkesen e perbashket të anetareve që përfaqësojnë bashkërisht të paktën 10% të kapitalit të shoqërisë. Ortakët duhet të njoftohen 15 ditë përpara nepermjet letres rekomande ose Kërkeses me shkrim për mbledhje, kur nenshkruhet marrja e njoftimit nga Ortaku perkates. Në lajmërim duhet të jetë shkruar vendi, ora dhe problemet që do të trajtohen.

Në qoftëse Asambleja është mbledhur sipas rregullave të caktuara ajo mund të marrë vendim kur cdo anëtar i shoqërisë është prezent dhe nuk kundërshton mbledhjen e Asamblesë. Cdo anëtar i shoqërisë ka të drejtë të verë në rendin e ditës problemin që ai dëshiron. Për këtë duhet të informohen anëtarët pesë ditë përpara.

Vendimet merren me votimin aprovues të ortakeve apo përfaqësuesve të tyre me prokurë që përfaqësojnë me shume se gjysmen e pjeseve të kapitalit themelor.

## **TE DREJTAT E ASAMBLESE**

### **Neni 14**

Asambleja e ortakëve ka kompetencat e mëposhtme:

- a) Ka të drejtë të bëjë ndryshime në statut në rast kur janë dakord ortakët që përfaqësojnë tre të katërtat e kapitalit themeltar;
- b) Ka të drejtë të miratojë bilancin e shoqërisë dhe të bëjë ndarjen e fitimit;
- c) Ajo emëron administratorët, zëvendëson, ekspertët dhe revizorët kontabël;
- d) Ajo aprovon cdo lloj veprimi financiar që me ligj dhe me marrëveshje lihet në kompetencë të Asamblese;
- e) Percakton shperblimin për administratorët, ekspertët, revizorët kontabel;
- f) Bën transferimin e kuotave të të tretet;
- g) Bën lidhjen e kontratave për dhenie dhe marrje të drejtash ose ekskluzivitet për tregtimin dhe prodhimin e mallrave të shoqërisë si dhe kontrata në lidhje me organet shtetërore për pjesëmarrjen në tender, ankande ose aktivitete të tjera të

- rendesishme;
- h) Realizon blerje, shitje si dhe tjetërsim të pasurive të palujtshme të shoqërisë etj;
  - i) Ka të drejtë të bëjë modifikimin e kontratës së shoqërisë.

### **Neni 15**

Asambleja është e zakonshme dhe e jashtëzakonshme. Asambleja mbledhet të paktën 1 herë në vit, brenda 4 muajve nga dita e mbylljes së veprimtarisë. Në kushte të veçanta Asambleja e zakonshme mund të mbledhet dhe brenda 6 muajve nga dita e mbylljes së veprimtarisë së shoqërisë.

Asambleja e jashtëzakonshme thirret kur Organi Administrativ e sheh të arsyeshme ose kur kërkohej nga ortakët që përfaqësojnë 10% të kapitalit të shoqërisë. Në këtë rast Organi Administrativ ka të drejtë të vendosë ditën e mbledhjes jo më larg se 30 ditë nga dita e kërkesës.

### **Neni 16**

Kur pjesëmarrja në asamble arrin koorumin vendimet që merren brenda kufijve të kontratës së themelimit, Statutit e të ligjeve janë të detyrueshme për të gjithë, edhe për ata që nuk kanë diskutuar edhe për ata që nuk janë dakord.

Cdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër që nuk është administrator ose nga një i përfaqësues i paisur me prokurë. Asnjë i dërguar nuk mund të përfaqësojë më shumë se një ortak.

Në Asamblenë e Ortakeve marrin pjesë nëse është e nevojshme për të dhënë mendim dhe me të drejtë vote eksperte, revizorë etj.

Shoqëria do të ketë si parim të saj gjatë gjithë veprimtarisë së saj kolegjalitetin gjë që do të thotë se për çdo lloj veprimi në shoqëri e për më tepër për veprime financiare duhet të merret patjetër vendim kolegjal, askush nga ortakët nuk ka të drejtë të veprojë në mënyrë individuale.

Kjo bëhet për të siguruar ekzistencën e shoqërisë, për të ruajtur vlerat dhe pasuritë e saj.

### **Neni 17**

Asambleja konsiderohet e thirrur kur :

a) në thirrjen e parë sigurohet prania e secilit ortak ose e përfaqësuesit të tij me prokurë nga persona të tretë me prokurë të posaçme dhe që zotërojnë 100% të kapitalit themeltar. Në këtë rast mund të diskutohet dhe të merret çfardo vendim që përputhet me statutin dhe aktin e themelimit të shoqërisë ose mund të ndryshohet vete statuti nëse pro ndryshimit votojnë ortakët që përfaqësojnë tre të katërtat e pjesëve të kapitalit themelor;

b) në thirrjen e dytë sigurohet pjesëmarrja personale e ortakeve (ose e përfaqësuesve të tyre me prokurë) të cilët zotërojnë tre të katërtat e të kapitalit themeltar. Në këtë rast mund të diskutohet dhe të merret çfardo vendim që përputhet me statutin dhe aktin e themelimit të shoqërisë ose mund të ndryshohet vete statuti nëse pro ndryshimit votojnë ortakët që përfaqësojnë tre të katërtat e pjesëve të kapitalit themelor

c) asambleja mbledhet, realizon konsultimin dhe mund të vendosë edhe kur në të marrin pjesë ortakët (ose përfaqësuesit e tyre me prokurë) të cilët zotërojnë më shumë se gjysmën e kapitalit themeltar. Në këtë rast asambleja, mund të vendosë me votimin pro të ortakeve (përfaqësuesit me prokurë) të cilët zotërojnë më shumë se gjysmën e kapitalit themeltar për gjithçka i lejon ky statut dhe legjislati në fuqi.

Ne rast se Kryetari i Asamblese nuk eshte prezent mbledhja shtyhet per nje date tjeter ne menyre qe ti jepet mundesia Kryetarit te Asamblese te marre pjese ne mbledhje. Kryetari i Asamblese mund te perfaqsohet ne mbledhje me ane e nje prokure te posaçme prej njerit prej ortakeve te shoqerise. Perfaqesuesi mund te veproje ne emer te tij pa qene e nevojshme shtyrja e mbledhjes.

#### **Neni 18**

Makrja e vendimeve te Asamblese, mbajtja e procesverbaleve dhe te gjitha dokumentat e tjera qe kane te bejne me te duhet te behen sipas legjislacionit ne fuqi per kete qellim.

#### **ADMINISTRIMI** **Neni 19**

Shoqeria administrohet nga nje Administrator i vetem i cili caktohet ne statutin e shoqerise dhe me pas nga Asambleja e Ortakeve. Administratori qendron ne detyre per nje periudhe te pakufizuar kohore dhe ne rast se gjate kesaj periudhe shfaqen probleme paaftesie nga ana e tij, Asambleja e Ortakeve vendos shkarkimin e tij duke treguar me fakte demin qe i eshte shkaktuar shoqerise nga paaftesia e tij pasi eshte dhene mendimi per kete dem edhe nga specialistet perkates. Asambleja mund te vendose lejimin e nje shperblimi ne favor te Administratorit per kryerjen e detyres pervec pagimit te shpenzimeve.

Aktualisht Administrator i shoqerise eshte **Z. DRITAN SHEHU** shtetas shqiptar, lindur me 01/05/1967 ne Tirane, mbajtes i pasaportes me nr. Z1380001 madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.

#### **Neni 20**

Administratori mund te emeruje nje ose me shume perfaqesues te thjeshte per te kryer veprime te vecanta duke percaktuar te drejtat e tyre brenda te drejtave qe atij i jane dhene nga ky statut, e duke e respektuar statutin dhe ligjet ne fuqi. Administratori vendos dhenien e nje shperblimi ne favor te tyre. Detyrat e tyre do te percaktohen ne nje rregullore te brendshme te shoqerise.

#### **Neni 21**

Administratori ka liri te plote per te kryer te gjitha veprimet e administrimit, te drejtoje shoqerine dhe mund te kryejne te gjitha llojet e veprimeve dhe cdo lloj marreveshje per realizimin e qellimeve te shoqerise dhe e angazhon ate ne perputhje me objektin e saj. Administratori nuk mundte kryej veprimet qe shprehimisht ne ligj dhe ne kete Statut i takojne Asamblese se Ortakeve.

#### **Neni 22**

Ky statut nuk i kufizon administratorit asnje kompetence te parashikuar per administratorin e shoqerise ne nenin 50 te Ligjit nr.7638 "Per Shoqerite Tregetare".

Administratori ka te gjitha kompetencat qe te pergatise dhe te nenshkruaje kontrata te ndryshme, poprosie dhe furnizimi ne interes te vete shoqerise apo te angazhoje shoqerine ne ndaj subjekteve te ndryshem publike dhe private.

Administratori ka te gjitha kompetencat te kryeje veprimtari bankare, te veprojne me cdo lloj instituti bankar publik e privat ne permbushje te objektit te shoqerise duke informuar periodikisht konform statutit asamblene e ortakeve.

Administratori ka kompetence te ndermarre veprime gjyqesore, transaksione te ndryshme, etj, si dhe ka te gjitha te drejtat qe jane parashikuar ne ligj sipas nenit 50 te tij.

Administratori eshte i detyruar te mbaje regjistrat e magazinimit te cilat vihen ne dispozicion te Zyres Doganore per te mundesuar kryerjen e kontroleve prej saj. Administratori i shoqerise eshte i detyruar te mbaje inventare te rregullta nje here ne muaj. Raporti i administrimit, inventari dhe llogarite vjetore, hartohen nga Administratori.

### **PJESMARRJA NE VENDIME** **Neni 23**

Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne vendime si dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron.  
Nje ortak mund te perfaqesohet nga nje ortak ose nga nje person tjeter me prokure te posacme.  
Nje ortak nuk mund te ngarkoje nje mandatmbajtes te votoje ne emer te nje pjese te kapitalit te tij themeltar duke votuar ai vete e emer te pjeses se tjeter te kapitalit te tij themeltar.

### **MARREDHENIET E PUNES** **Neni 24**

Mardheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria private merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar qe te respektojne Statutin e kesaj shoqerie dhe rregullat e brendeshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe i shkaktojne kesaj shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

### **KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETI** **Neni 25**

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumentave qe jane percaktuar si te tilla nga administratoret e kesaj shoqerie.

### **EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABEL** **Neni 26**

Kontrolli mbi veprimtarine e Administratorit, veprimtarine e tij si dhe gjithe aktivitetin e shoqerise i besohet nje eksperti ose revizori kontabel. Ky ekspert do te qendroje ne detyre per aq sa percaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet. Asambleja e Ortakeve cakton dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

### **BILANCI DHE FITIMET** **Neni 27**

Veprimtaria ekonomike e shoqerise do te mbyllet ne dt. 31 Dhjetor te cdo viti. Administratori merr masa per hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim - humbje dhe inventar. Pasi vecohen fondet si me siper dhe paguhen detyrimet fiskale, te ardhurat qe mbeten ndahen midis ortakeve dhe mund te transferohen lirisht jashte shtetit sipas dispozitave perkatese ligjore.



### **Neni 28**

Ne rast se kapitali i shoqerise per shkak te humbjeve te realizuara rezulton me pak se kapitali themeltar, pronaret vendosin brenda 4 (kater) muajve nga miratimi i llogarive qe pasqyrojne keto humbje mbi mundesine e prishjes separakohshme te shoqerise.

## **SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE**

### **Neni 29**

Ne rast se shoqeria shperndahet per cdo lloj arsye Asambleja e Ortakeve percakton menyren e likuidimit, emerone nje ose me teper likuidator dhe pergatit te gjitha dokumentet e nevojshme per c'regjistrimin e saj nga Regjistri Tregtar.

## **LIBRAT E SHOQERISE**

### **Neni 30**

Po keshtu shoqeria ne baze te ligjit mban librat e meposhtem:

- 1) Libri i Ortakeve
- 2) Libri i Mbledhjeve
- 3) Libri i vendimeve te administratorit
- 4) Libri i mbledhjeve dhe vendimeve te eksperteve ose revizoreve kontabel.

Librat e mesiperm duhet te jene te ruajtura per 10 vjet e cdo faqe duhet te jete e vulosur.

## **DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

### **Neni 31**

Persa eshte shprehur ne kete statut i referohemi ligjit 7638 dt 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", Statutit dhe rregullores se brendshme te shoqerise. Cdo ndryshim behet ne te njejten menyre sic eshte nxjerre ky Statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kesaj shoqerie.

Ky statut firmoset rregullisht nga ortaket e shoqerise.



**ORTAKET**

- z. Agim Jinn
- z. DRITAN SHEHU
- z. Artan Duleta
- z. Adnan Kulla
- z. Edlira Zevelaj
- z. Guoian Byben
- z. Buyat Hasaj
- z. \_\_\_\_\_